



## REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:194526

Datë: 24.01.2020

Numri i dokumentit: 00494229

**998/19**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**, gjyqtari Burim Emërllahu ,në çështjen juridike të paditësit D.H.1 ,nga Ferizaji,të cilin në bazë të autorizimit e përfaqësonë avokati XH.B ,nga Prishtina,kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ‘E...’,me seli në Prishtinë,të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson I.B ,baza juridike kompenzim dëmi,me datë 24.01.2020 ,mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I.PJESËRISHT APROVOHET** si e bazuar kërkespacia e paditësit D.H.1 nga Ferizaji dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve ‘E...’,me seli në Prishtinë që paditësit D.H.1 ,nga Ferizaji t’ia paguaj shumat si në vijim:për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 1800 euro,për frikën e përjetuar ,shumën prej 1500 euro , të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesën përfundimtare.

**II.DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve ‘E...’,me seli në Prishtinë , që paditësit D.H.1 ,nga Ferizaji në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tia paguaj shumat si në vijim :për përpilimin e padis 104 euro,për tri seanca të mbajtura 405 euro,për ekspertiza mjekësore 200 euro, në emër të taksës gjyqësore për padi 20 euro.

**III.**Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadis së paditësit D.H.1 ,nga Ferizaji , me të cilën ka kërkuar nga gjykata që detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve ‘E...’,me seli në Prishtinë që paditësit D.H.1 ,nga Ferizaji tia paguaj shumat si në vijim:për ushqim të përforcuar ,shumën prej 200 euro,në emër të ndihmës së huaj 250 euro, , të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padis e deri në pagesën përfundimtare.

### **A r s y e t i m**

Paditësi D.H.1 ,nga Ferizaji ,ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ‘E...’,me seli në Prishtinë,me bazë juridike kompensim dëmi.

Nga thënjet e palës paditëse rezulton se pala paditëse padin e bazon në arsyen se me datën 09.05.2018 aty rreth ores 23:45 minuta ,ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor rrugorë, të cilin e ka shkaktuar B.Z ,me përdorimin e automjetin të udhëtarëve ‘Hyunday’,me targa të regjistrimit ..., dhe si pasojë e këtij aksidenti paditësi D.H.1 ka pësuar dëm material dhe jomaterial.

E paditura në lidhje me qështjen kontestuese në përgjegjje në padi ka theksuar: e kontestojmë në tërësi kërkesëpadin si për nga baza edhe për nga lartësia për dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksident.Bazën juridike të kërkesëpadis e kundërshtojmë sepse me asnjë provë nuk vërtetohet se paditësi D.H.1 ka qenë pjesëmarrës në këtë aksident .

Përfaqësuesi i të paditurës I.B në seancë gjyqësore ka theksuar: mbetem në tërësi pranë përgjegjjes në padi i propozoj gjykatës që kërkesëpadin e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ,sepse me asnjë prove materiale që gjindet në shkresat e lendës nuk vërtetohet se paditësi ka qenë pjesëmarrës-bashkëudhëtar në aksidentin e datës 09.05.2018.Është e vërtetë se i siguruar i të paditurës është shkaktar i aksidentit të datës 09.05.2018 ,ky fakt është jo kontestues ndërmjet palëve.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo juridike janë administruar si provë: raporti policor i aksidentit i dt. 09.05.2018. nr.2017-CF-772,njoftimi i datës 22.05.2018 numër 691/18/02 ,i lëshuar nga e paditura ,mendimi dhe konstatimi i ekspertit ortoped traumatolog H.G i datës 03.03.2019 ,mendimi dhe konstatimi i ekspertit psikiatër ,i datës 12.12.2019.

Gjykata pasi vlerësoi provat e administruara dhe deklaratat e palëve ndërgjyqëse të dhëna nëpërmes të autorizuarve të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me leximin e raportit policorë të aksidentit ,i datës 09.05.2018 ,me numër 2017-CF-772 ,gjykata ka vërtetuar se me datë 09.05.2018 ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor në të cilin si pjesëmarrës ishin automjeti Hyunday ,me targa të regjistrimit ... i siguruar te e paditura ,të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte B.Z,si dhe automjeti WV Tiguan ,me targa të regjistrimit ... të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte D.H.2.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues ekzistimi i fakti se me datën 09.05.2018 ,ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor rrugorë, të cilin e ka shkaktuar B.Z ,me përdorimin e automjetin të udhëtarëve ‘’Hyunday’’,me targa të regjistrimit ... , I cili në ditën e aksidentit kishte sigurim të vlefshëm te e paditura.

Me leximin e ekspertizës mjekësore e hartuar nga mjeku: dr. H.G ortoped traumatolog gjykata ka vërtetuar se paditësi D.H.1 si pasojë aksidentit të datës 09.5.2018 ka pësuar dëmtime të lehta trupore si dhe : dhimbje fizike me intensitet të rëndë 2 ditë,kjo për shkak të tronditjes trupore të shkaktuar,kohë e nevojshme deri në sanimin e tej zgjatjeve dhe mikrohemorragjive që mund të ndollin 48-72 h e para pas aksidentit ,kohë e mjaftueshme për stabilizimin e hemosatzes dhe edemës së mundshme..Dhimbje fizike me intensitet të mesëm 12 ditë kohë e domosdoshme për fillimin konsolidimit të indeve në në gjendjen-formën e mëparshme si ulje e edemave të shkaktuara nga ngacmimet e nervave periferik të cilat vijnë si pasojë e shkaktuar nga gjakderdhjet e brendshme ..Dhimbje të intenzitetit të lehtë 2 muaj ka ndjer sidomos në sforcime të forta fizike dhe në ndryshimet e motit. Ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 20 ditë,ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë 10 ditë,ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterikë 10 ditë.

Me leximin e ekspertizës mjekësore të hartuar nga, dr. M.A psikiatër gjykata ka vërtetuar se paditësi D.H.1 si pasojë aksidentit të datës 09.05.2018 ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatë 3 ditë e që është manifestuar me pengesa në gjum dhe ëndrra të kqija me përmbajtje të aksidentit ,kurse ditën kishte rikujtime të shpeshta t’ë aksidentit ,shqetësohej shumë ,kur i kujtohej krisma nga goditja e veturave dhe kjo e bënte shumë të pasigurtë për të marrë pjesë në komunikacion ,.Pas kësaj frika kalon në:Frikë sekondare të intesitetit të mesëm që zgjatë 1 javë e që është manifestuar me pengesa në gjumë ,me rikujtime më të rralla të aksidentit dhe me pasiguri për të marrë pjesë në komunikacion ,sepse kishte vështëresi me besu në ndonjë vozitës se nuk do të pëson prap aksident .Pas kësaj pason frika sekondare e intenstitetit të ulët dhe 3 javë me të njejta siptome por më të rralla dhe me intensitet më të ulët.

Me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës dhe me dëgjimin e dëshmitarit D.H.2 nga Ferizaji rr... në cilisë të dëshmitarit gjykata ka vërtetuar se paditësi ka qenë bashkëudhëtar në momentin e aksidentit të datës 09.05.2018 në veturën Tiguan,me tabela të regjistrimit ... vetur kjo e aksidentuar në askidentin e sipër përmendur ,të cilave deklarata gjykata ua fali besimin sepse faktin se paditësi si pasojë eksidentit ka pësuar lëndim trupor vërtetohet edhe nga konstatimi i dr. H.G ortoped traumatolog ,i cili përveq tjerash mendimin dhe konstatimin e tij e bazon në rap.S.P.Ferizaj –i emergjencës dat 10.05.2018 ora 00:30 me numër prot 58 ,e që rezulton se është lëshuar afër kohës kur ka ndollur aksidenti kohë kjo data 09.05.2018 ora 23:45 minuta të natës.Po ashtu fakti se paditësi ka pësuar frikë në aksidentin në fjalë vërtetohet dhe nga mendimi dhe konstatimi i i ekspertit psikiatër M.A,i datës 12.12.2019,i cili mendim përveq tjerash bazohet edhe në raportin në fjalë të aksidentit.Përveq kësaj e paditura në procedurë jashtë shqësore rezulton ti ketë ofruar kompenzim prej 150 euro paditësit , i cili fakt vërtetohet edhe nga njoftimi datës 22.05.2018 ,me numër të lëndës 691/18/02.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike gjykata ka nxjerrë përfundim se kërkespadija e paditësit D.H.1 është pjesërisht e bazuar, sepse nga provat e administruara dhe faktet jokontestuese u vërtetua se me se me datën 09.05.2018 ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor ,të cilin e ka shkaktuar B.Z ,me përdorimin e automjetin të udhëtarëve ‘Hyunday’,me targa të regjistrimit ...., I cili në ditën e aksidentit kishte sigurim të vlefshëm të e paditura , paditësi ka qenë bashkëudhëtar në momentin e aksidentit të datës 09.05.2018 në veturën Tiguan,me tabela të regjistrimit ... vetur kjo e aksidentuar në aksidentin e sipër përmendur dhe si pasojë e këtij aksidenti paditësi D.H.1 ka pësuar dhimbje fizike ,frikë, dhe kjo gjykatë ka marr për bazë edhe dispoziten e nenit 183 të LMD-së,së Kosovës në lidhje me nenin 136 të LMD-së së Kosovës ,sa i përket dëmit jomaterial..

Sa i përket pjesës së kërkespadiës së paditësit D.H.1 me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit D.H.1 t’ia paguaj shumat : në emër të ushqimit të përforcuar ,shumën prej 200 euro ,në emër të ndihmës së huaj shumën prej 250 euro gjykata në këtë pjesë kërkespadin e paditësit e ka refuzuar sepse paditësi nuk kan arritur ta vërtetoin faktin me prova, se me të vërtetë kanë bërë hargjime në emër të dëmit sipas këtyre bazave.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së së Kosovës.

Gjykata bazuar në dispozitat e neneve 452.5 454.1,453.2 të LPK-së e ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimit që paditësit t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës ,si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ,duke u bazuar sa i përket shpenzimeve: për përfaqësimin e paditësit në seanca gjyqësore,për përpilim të parashtrësve , edhe në tarifen e OAK-ut të Kosovës.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Me datë 24.01.2020**

**Gjyqtari : Burim Emërllahu**

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:**kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.

